



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit



Nr 01-030/01-52426 dt. 11/12/2025

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 pika (h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: që në bazë të nenit 12 dhe 40 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës"), nenit 53 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 3, 7, 8, 9 të Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr.05/2020 për Procedurat e Themelimit, Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve Tjera në Komunë, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datë 17.12.2025 propozoi këtë:

PROPOZIM VENDIM
Për themelimin e Komitetit për Komunitete

Neni 1

Më këtë Propozim Vendim i propozohet Kuvendit të Komunës themelimi i Komitetit për Komunitete në këtë përbërje:

1. _____ -Anëtarë;
2. _____ -Anëtarë;
3. _____ -Anëtarë;
4. _____ -Shoqëria Civile;
5. _____ -Komuniteti i biznesit.

Neni 2

Komiteti për Komunitete është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha çështjeve të parapara me nenin 53.2 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 7 të Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr.05/2020 për Procedurat e Themelimit, Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve Tjera në Komunë, si dhe legjislacionit tjetër në fuqi.

Neni 3

Mandati i komitetit për Komunitete është katër (4) vjeçar ashtu sikurse anëtarët e Kuvendit si dhe përfundon me përfundimin e mandatit të anëtarëve të kuvendit.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit nga Kuvendi i Komunës dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga ana e MAPL-së.

 **Kryetari i Komunës**
Ramiz Lladrovci

ARSYETIM

Themelimi i komiteteve të përhershme është përcaktuar me nenin 51 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, si dhe me nenin 3 të Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr.05/2020 për Procedurat e Themelimit, Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve Tjera në Komunë.

Komiteti për Komunitete themelohet dhe është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, si dhe dokumentet e planifikimit strategjik; kornizën vjetore buxhetore afatmesme; planin vjetor të prokurimit; rregulloren vjetore për tatimet, tarifatat dhe pagesat; buxhetin vjetor afatmesëm dhe çdo ndryshim të buxhetit gjatë vitit fiskal si dhe për marrjen e raporteve nga kryetari dhe dorëzimin e rekomandimeve në Kuvendin e Komunës.

